



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian  
në Kosovë



### Raport nga konferenca:

Raportimet e mediave lidhur me paqen, konfliktin dhe çështjet e sigurisë – sa janë objektive dhe të ndjeshme mbulimet / raportimet mediale në këto çështje”

31 Mars 2014, Hotel Sirius, Prishtinë

## Hyrje

Më 31 mars 2014, FIQ dhe AKTIV, me mbështetjen e Saferworld, në kuadër të zbatimit të projektit **“Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë për t’u bërë kontribues të efektshëm të procesit të hartimit të politikave të sigurisë dhe të vendimmarrjes”**, organizuan konferencën me titull **“Raportimi i mediave për paqen, konfliktin dhe çështjet e sigurisë – sa objektiv dhe i ndjeshëm ndaj konfliktit është raportimi për këto çështje?”**

Qëllimi i kësaj konference ishte paraqitja publike e raportit, si dhe diskutimi me palët me interes nga radhët e medieve, të institucioneve të sigurisë dhe të shoqërisë civile lidhur me perceptimet e qytetarëve të Kosovës për ndjeshmërinë dhe objektivitetin e raportimeve të medieve mbi çështjet e paqes, konfliktit dhe sigurisë në Kosovë.

Ky raport është hartuar bashkërisht nga njëmbëdhjetë organizata, duke përfshirë edhe dy anëtare të Forumit për Siguri në Prishtinë, tri anëtare të Forumit për Parandalimin e Konfliktit në veri, gjashtë OShC vendore nga komuna të ndryshme dhe dy partnerë të projektit – AKTIV dhe FIQ.

Për nevoja të këtij hulumtimi janë organizuar takime dialoguese në formatin e “grupeve të fokusit” me qytetarë në 7 komuna: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë, Prizren, Leposaviq dhe Zubin Potok. Fokus grupet kanë pasur përbërje të përzier etnike, gjinore dhe shoqërore.



Tryeza mblodhi përfaqësues të institucioneve, si Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës; organizatat ndërkombëtare, përfshirë OSBE, ICITAP; analistë të sigurisë dhe aktivistë të shoqërisë civile.

## **Përmbledhje e diskutimeve kryesore**

Konferencën e hapi Nazim Haliti nga FIQ, ndërkaq një fjalë hyrëse paraqiti Ferdinand Nikolla nga Saferworld. Z.Nikolla u shpreh se organizatat joqeveritare nuk janë marrë shumë me këtë temë, përveç në kohë zgjedhjesh dhe se është tejet e rëndësishme të diskutojmë për objektivitetin e raportimit të medieve për çështjet e ndërlidhura me sigurinë. z. Nikolla shtoi se mediet kanë gjithashtu ndikim të madh në nivelin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve. Ai më pastaj ngriti disa pyetje, siç janë: “A ka raportim objektiv të medieve për çështjet e paqes, konfliktit dhe të sigurisë në Kosovë? A janë arrestimet lidhur me korrupsion dhe krime të luftës senzacionale apo mediet i bëjnë të tilla? Pse askush më nuk flet për vendimin nga viti i kaluar të Komisionit të Pavarur për Media për ndalimin e përdorimit të emërtimeve të partive politike dhe të emrave të kandidatëve të tyre gjatë heshtjes zgjedhore? A është konkurrenca duke i shtyrë mediet në Kosovë për të raportuar më shumë për çështje negative (skandale) sesa për ato pozitive, në mënyrë që të tërheqin vëmendjen e qytetarëve? Mediet në internet shumë shpesh trajtojnë çështje fetare, dhe problemi qëndron se për shumë sosh nuk e dimë se kush është pronari (redaktori)?!

Më pastaj raporti është paraqitur nga autori i tij, z. Shkamb Qavdërbasha, hulumtues në organizatën INDEP (anëtare e Forumit për Siguri).

Ai ka përmendur të gjeturat kryesore nga perceptimet e qytetarëve lidhur me raportimin e mediave, duke veçuar si në vijim:

- Legjislacioni në fuqi në Kosovë rregullon mediat përmes dy organeve rregulluese: Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Media, të cilat rregullojnë mediat e shkruara dhe ato elektronike. Nuk ka trupa zyrtarë rregullues për mediet online, gjë e cila është edhe arsyeja e rritjes së shpejtë të numrit të tyre.
- Një nga shtyllat kryesore të ndërtimit të paqes mbeten mediat. Me qasje direkte tek pjesë të konsiderueshme të popullatës, mediat janë në një pozitë të mirë për të mbështetur përpjekjet për stabilitet dhe siguri. Në një shtet me grupe të shumta etnike dhe një të kaluar të dhunshme, mediet duhet të tregojnë kujdes të madh kur mbulojnë çështje të ngarkuara emocionalisht. Dështimet në këtë aspekt rrezikojnë rritjen e tensioneve.
- Gjatë disa muajve të fundit dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit është trajtuar me prioritet në raportet e medieve. Raportimi për dialogun nxitet nga mediet vendore, dhe në përgjithësi perceptohet se është i paanshëm. Megjithatë, ekziston potenciali i perceptuar i nxitjes së konfliktit për shkak të dykuptimisë dhe të mungesës së perceptuar të objektivitetit të raportimit për këtë çështje.

- Siç theksuan pjesëmarrësit, qytetarët në përgjithësi nuk i përcjellin mediet e transmetuara në gjuhët e etniteteve të tjera, me përjashtim të brezave më të vjetër të popullatës shqiptare. Megjithatë, mund të arrihet në përfundim se ekziston perceptim i përgjithshëm që mediet në Kosovë, me rastin e mbulimit të çështjes së ndërlidhur me etninë tjetër, kanë tendenca të raportojnë në mënyrë të anshme, duke mos refuzuar e madje edhe duke e përdorur gjuhën konfliktnxitëse.

Pas prezentimit të raportit, fjala u është dhënë panelistëve. z. Naim Rashiti nga organizata Grupi për Hulumentimin e Politikave të Ballkanit theksoi faktin se qasja e përdorur në këtë raport duhet të vazhdohet dhe të shtrihet edhe në rajon. Përveç kësaj, Rashiti theksoi se mediet janë tejët pak të përfshira në çështjet e sigurisë dhe po ashtu tha se mediet nuk kanë qenë shumë aktive në pajtimin e grupeve etnike. Më problematike nga ana e tij shihet qasja e medieve shqiptare dhe serbe tek grupet e kundërta etnike (mediet shqiptare në qasjen ndaj grupeve serbe dhe e anasjelltas). Ai tha se për shkak të kontekstit legal në Kosovë, mediet serbe dhe ato shqiptare kanë interpretime të ndryshme.

Si një ndër çështjet kryesore që duhet të merren parasysh, z. Rashiti identifikon faktin se mediet në përgjithësi nuk kanë qenë pjesë e procesit të pajtimit të dy etnive kryesore (shqiptarëve dhe serbëve), ku në mes të tjerash tha se: “Si mediet shqiptare, ashtu edhe ato serbe u përmbahen orientimeve politike të qeverisë përkatëse. Unë po ashtu mendoj se ka mungesë të komunikimit mes qytetarëve dhe gazetarëve. Për të ardhur deri te një zgjidhje e caktuar apo te një përmirësim i rolit të medieve në formësimin e perceptimeve të qytetarëve lidhur me çështjet e sigurisë, qasja duhet të ndryshojë në qasje nga lartë-poshtë, që do të thotë se qasja për çështjet e sigurisë së pari duhet të ndryshojë në nivele politike dhe të qeverisë, pasi që ato ndikojnë në shndërrimin e porosive të rëndësishme nga mediet në informata të besueshme për qytetarë me qëllim të absorbimit dhe formësimin të perceptimeve të tyre.

Znj. Dajana Berisha, drejtoreshë ekzekutive e FIQ-it, së pari konfirmoi rolin e këtij hulumentimi, duke cekur se i njëjti ishte shumëdimensional, marrë parasysh se ka për qëllim t’i kontribuojë literaturës ekzistuese për raportimin e medieve mbi çështje të paqes, konfliktit dhe të sigurisë; për nxitjen e debatit publik për këto çështje të ndjeshme dhe në fund, për marrjen e perceptimeve të qytetarëve mbi rolin e medieve në këtë proces të paqes dhe të pajtimit. Po ashtu, ajo gjithashtu theksoi se shumica e pjesëmarrësve të konferencës pajtoheshin që shoqëria në Kosovë është në proces të ndërtimit të kohezionit social, ku të gjithë akterët e shoqërisë, si dhe palët politike dhe jopolitike me interes qëndrojnë në nivel të caktuar paralel brenda shoqërisë.

Z. Ibrahim Shala, udhëheqës i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, foli për tri raste ku policët dhe zyrtarët e sigurisë kanë qenë viktimë kur mediet kanë qenë spekulative për njerëzit e përfshirë në raste të vrasjeve. Ai vuri në pah se mediet nuk janë profesionale dhe se nuk kanë gazetarë të specializuar në sektorin e sigurisë. “Gjithashtu, kur kemi të bëjmë me tema të nivelit të lartë politik, mediet duhet të jenë shumë të kujdesshme për të mbrojtur interesin shtetëror”, nënvizoi Shala.

Z. Hamdi Mehmeti, gazetar i News TV theksoi se mediet duhet të kenë qasje më të ndjeshme ndaj dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës. Ai po ashtu tha se zhvillimi i gazetarisë hulumtuese në përgjithësi shihet si një trend pozitiv.

Z. Rifat Marmullaku, ekspert për siguri, u pajtua se ka mungesë të profesionalizimit në raportimin për çështje të sigurisë. Megjithatë, nga përvoja ime policore, raportimi për raste të vrasjes është një çështje e ndërlikuar në gazetari. “Mediet kanë nevojë për trajnime për mënyrën e raportimit të çështjeve të sigurisë, edhe pse nuk është lehtë për ta pasi që shumë institucione nuk janë të hapura dhe transparente ndaj tyre”, vuri në pah z. Marmullaku.

Z. Brahim Sadriu, zëdhënës i Policisë së Kosovës, tha se PK-ja dhe mediet kanë marrëdhënie konstruktive, dhe se raportet mediale e lavdërojnë, por edhe e kritikojë punën e tyre.

Z. Branisllav Neshoviq, drejtor i programit në organizatën AKTIV, foli për marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve, si dhe mungesën e kuptueshmërisë mes dy bashkësive që është pasqyruar në aspekte të tjera, duke përfshirë edhe raportimin e medieve. “Përveç kontrollit politik, ndaj të cilit mund të nënshtrohen, pavarësia financiare është gjithashtu sfidë e madhe për mediet. Raportimi i medieve në përgjithësi është përplot me stereotipe, për shembull, mediet në jug bëjnë raportime të përgjithësuara për veriun dhe e portretizojnë atë si një territor me plot kriminelë, ndërsa në veri nuk ka edhe aq shumë medie që përcjellin lajmet nga jugu, tha z. Neshoviq. Ai nënvizoi se ekziston vetëm një medie në internet në veri, e cila përcjell dhe jep komente për mbulimin medial në shqip.

### **Diskutime dhe konkluzione:**

- Mediet synojnë që të raportojnë në mënyrë sa më objektive që të jetë e mundur, sidoqoftë kjo shpesh përcillet me një trend të raportimit sensacional për të rritur vëmendjen e publikut;
- Ka një mungesë të gazetarëve të profilizuar që mbulojnë kryesisht çështjet e sigurisë dhe ata gazetarë ndërrohen shpesh, gjë që kjo ndikon në nivelin e profesionalizimit gjatë raportimit;
- Mediet janë proaktive në përcjelljen dhe raportimin e zhvillimeve të rëndësishme shoqërore, politike dhe të sigurisë, sidoqoftë redaktorë/gazetarë të medieve të caktuara duhet të jenë më të përfshirë në debatet konstruktive, sikur ky sot, që targetojnë drejtpërdrejtë ata, në mënyrë që të rritet kualiteti i raportimeve mediale në çështjet relevante që kanë ndikim në perceptimet e qytetarëve për paqen edhe sigurinë në Kosovë;
- Klima politike në vend, në përgjithësi, është faktori përcaktues i frymës dhe qasjes së raportimeve mediale lidhur me çështjet e ndjeshme;
- Ka dallime kur bëhet fjalë se si shqiptarët dhe serbët në Kosovë perceptojnë neutralitetin dhe objektivitetin e medieve gjatë raportimit;

- Duhet të vihet më shumë theks në arritjen e pavarësisë së vërtetë (posaçërisht asaj financiare) të medieve, me qëllim të pengimit të çuarjes përpara të çfarëdo agjende të fshehtë dhe të dhënies së kontributit për raportim të paanshëm e profesional.



#### **Pjesëmarrës:**

1. Rifat Marmullaku, OSBE
2. Ymeri Thaçi, MPB
3. Ibrahim Shala, MFSK
4. Elvedina Megjuani, gazetare
5. Florentina Makolli, gazetare
6. Beadin Sylja, Kosovapress
7. Senad Kamenica, OSBE
8. Naim Rashiti, BPRG
9. Dajana Berisha, FIQ
10. Nazim Haliti, FIQ
11. Arieta Rexhepi, FIQ
12. Ferdinand Nikolla, Saferworld
13. Arianita Beqa-Rraci, Saferworld
14. Branislav Neshoviq, AKTIV

15. Jana Poljakova, AKTIV
16. Nart Orana, INDEP
17. Enver Dugolli, MFSK
18. Hamdi Mehmeti, News TV
19. Hamdi Bytyqi, News TV
20. Lulzim Fushtica, ICITAP
21. Arben Hajredinaj, OSBE
22. Aferdita Duraku, RTV21
23. Valdete Berisha, Kosova Sot
24. Diellza Kryeziu, ETNIKA
25. Bedri Uka, OJQ “Shpëtimtari”

Raporti i plotë mund të gjendet në faqet vijuese të internetit:

[http://fiq-fci.org/repository/docs/FS\\_RAPORTIMI-MEDIAVE-PAQEN.pdf](http://fiq-fci.org/repository/docs/FS_RAPORTIMI-MEDIAVE-PAQEN.pdf)

<http://fiq-fci.org/repository/docs/MEDIA-REPORTING-ON-PEACE%202014.pdf>

<http://ngoaktiv.org/fajlovi/FB,%20MEDIJSKO%20IZVE%20C5%A0TAVANJE%20O%20MIRU..mart.2014.pdf>



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë